

# RAPORT VJETOR

## KËSHILLI I STATISTIKAVE VITI 2024

### PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Viti 2024 u karakterizua nga ngjarje të rëndësishme institucionale dhe teknike, përfshirë menaxhimin e pasojave të sulmit kibernetik ndaj INSTAT, publikimin e të dhënave të Censit të Popullsisë dhe Banesave 2023, dhe avancimin e përgatitjeve për Censin e Bujqësisë.

Në mbledhjet e realizuara gjatë vitit, Këshilli ka shqyrtuar raportimet e monitorimit të Programit Statistikor Zyrtar, zhvillimet teknike dhe rekomandimet strategjike. Diskutimet u fokusuan në sigurimin e cilësisë së të dhënave, ruajtjen e besueshmërisë teknologjike, përmirësimin e kapaciteteve njerëzore dhe rritjen e transparencës në raportim dhe komunikim publik.

Raporti paraqet një përmbledhje të gjetjeve, vlerësimeve dhe rekomandimeve të Këshillit me qëllim forcimin e Sistemit Statistikor Kombëtar dhe rritjen e kapaciteteve institucionale për përmbushjen e kërkesave të procesit të integritetit evropian

### VEPRIMTARIA GJATË 2024

Në vitin 2024, Këshilli i Statistikave zhvilloi pesë mbledhje zyrtare.

Gjatë vitit 2024, Këshilli zhvilloi pesë mbledhje zyrtare, në të cilat u trajtuan çështje të rëndësishme që lidhen me monitorimin e Programit të Statistikave Zyrtare, funksionimin institucional të INSTAT dhe proceset kryesore statistikore të vitit. Takimet u zhvilluan sipas datave dhe tematikave si më poshtë:

### MANDATI LIGJOR DHE ROLI

Këshilli i Statistikave ushtron funksionet e tij në mbështetje të një sistemi statistikor të besueshëm, të pavarur dhe të orientuar nga nevojat e publikut, në përputhje me kompetencat e përcaktuara në Ligjin e Statistikave Zyrtare, përfshirë:

- Dhënien e mendimeve për Programin Pesëvjeçar të Statistikave Zyrtare
- Planet vjetore hartuar në bazë të PSZ pesë vjecare
- Monitorimin e zbatimit të planit vjetor të statistikave;
- Vlerësimin e performancës së statistikave zyrtare dhe progresit drejt standardeve europiane;
- Promovimin e transparencës, qasjes dhe përdorimit të statistikave.

- Më 8 shkurt 2024, mbledhja u fokusua tek informimi dhe vlerësimi i situatës së krijuar nga sulmi kibernetik ndaj INSTAT, ndikimi i tij në proceset statistikore dhe masat e marra për ringritjen e sistemeve dhe garantimin e funksionimit institucional. Diskutimet përfshinë edhe çështje të lidhura me strukturën organizative dhe përgatitjet për seancën dëgjimore në Komisionin e Ekonomisë.
- Më 25 mars 2024, Këshilli shqyrtoi Draft-Raportin Vjetor 2023 të INSTAT, vlerësoi përmbajtjen dhe strukturën e tij dhe mori në analizë raportimin mbi zbatimin e Programit Statistikor për periudhën Shtator–Dhjetor 2023. Në këtë mbledhje u dhanë sugjerime për qartësimin e informacionit, shprehjen e indikatorëve të performancës dhe strukturimin e materialeve për një audiencë më të gjerë përdoruesish.
- Më 4 qershor 2024, mbledhja u përqendrua në çështje të lidhura me publikimin e të dhënave të Censit të Popullsisë dhe Banesave 2023, përgatitjen e materialeve analitike dhe procesin e prezantimit publik. Po ashtu, në këtë takim u prezantuan dy anëtarët e rinj të Këshillit, duke reflektuar zgjerimin e përfaqësimit institucional. Diskutimet gjithashtu adresuan rëndësinë e komunikimit metodologjik transparent me publikun dhe median.
- Më 17 tetor 2024, Këshilli shqyrtoi raportimin e monitorimit të PSZ-së për periudhën Maj–Gusht 2024, duke vlerësuar ecurinë e publikimeve statistikore, transmetimet ndërkombëtare dhe zbatimin metodologjik. U informua gjithashtu mbi procesin e publikimit të detajuar të të dhënave të Censit dhe mbi ecurinë e përgatitjeve për Censin e Bujqësisë. Në këtë takim u theksua rëndësia e kapaciteteve njerëzore dhe mirëfunksionimit institucional.
- Më 20 nëntor 2024, mbledhja u fokusua ekskluzivisht te shqyrtimi i draft–Planit Vjetor të Statistikave për vitin 2025. Diskutimet u orientuan drejt prioritetëve të planifikimit, sinkronizimit me kërkesat e Eurostat dhe procesit të integritetit, si dhe nevojës për një strukturim të qartë të objektivave strategjike dhe indikatorëve matës. Dokumenti u miratua në parim, duke u shoqëruar me rekomandime për përmirësim.

Diskutimet u karakterizuan nga angazhim konstruktiv, vëzhgime teknike dhe këshilla të orientuara drejt përmirësimit të cilësisë, aksesit dhe harmonizimit të statistikave.

Bazuar në raportimet e INSTAT dhe agjencive statistikore, Këshilli vlerëson:

- |                                                                                                                                                                                                                                                 |                                                                                                                                                                                                                                                 |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <ul style="list-style-type: none"> <li>• Reagim të shpejtë dhe të strukturuar ndaj sulmit kibernetik, me ruajtje të integritetit të të dhënave;</li> <li>• Progres në publikimin e të dhënave të Censit dhe rritjen e transparencës;</li> </ul> | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Performancë të qëndrueshme në realizimin e publikimeve statistike, pavarësisht sfidave operacionale;</li> <li>• Rritje të bashkëpunimit ndërinstitutional në kuadër të acquis dhe Eurostat.</li> </ul> |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|

Në përfundim të vlerësimit të veprimtarisë gjatë vitit 2024, Këshilli vlerëson reagimin e shpejtë institucional ndaj sfidave teknike dhe progresin domethënës në publikimin e të dhënave të Censit dhe garantimin e transparencës. Pavarësisht sfidave operacionale, u konstatua performancë e qëndrueshme në realizimin e publikimeve statistikore dhe një rritje e bashkëpunimit ndërinstitucional në përputhje me kërkesat e acquis dhe Eurostat.

## REKOMANDIME

---

Duke u bazuar në informacionet e paraqitura, analizat krahasimore dhe praktikat europiane, Këshilli paraqet këto rekomandime:

1. Forcimi i infrastrukturës IT, sigurisë kibernetike dhe burimeve teknike;
2. Këshilli sugjeron vlerësimin e mundësive për rishikimin ose rritjen e pagave, veçanërisht për pozicionet kritike, si një masë e domosdoshme për ruajtjen e ekspertizës dhe qëndrueshmërisë së kapaciteteve profesionale.
3. Rritje e komunikimit dhe edukimit statistikor publik, me fokus publikimet e censit dhe indikatorët makro-ekonomikë;
4. Zgjerim i përdorimit të burimeve administrative të të dhënave dhe automatizim i proceseve analitike në përputhje me ESS.
5. Mbështetje për përgatitjet e Censit të Bujqësisë, duke garantuar planifikim, burime dhe standardizim metodologjik.